



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIVJAKË

SEKTORI JURIDIK PROKURIMEVE PUBLIKE DHE MENAXHIMIT TË ASETEVE  
Nr. 55 Prot. Divjakë, më 15.08 2025.

PROJKET - VENDIM

Nr. 55, datë 15.08 2025.

**“TË MIRATOJË PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË PRIVATIZIMIT TË BANESAVE TË CILAT KANË MBETUR PA U REGJISTRUAR NË AGJENCINË SHTETËRORE TË KADASTRËS, DREJTORIA VENDORE LUSHNJE, PËR LIDHJEN E KONTRATAVE PARA NOTERIT”.**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015 , datë 17.12.2015 “ *Për Vetëqeverisjen Vendore* ”, (i ndryshuar), me VKM nr. 97 datë 03.02.2008, “ Për procedurat e privatizimit të banesave shtetërore objekt i Ligjit nr. 7652 datë 23.12.1992 dhe Ligjit nr. 9321 datë 25.11.2004 “ Për trajtimin e banesave dhe objekteve të kthyer në banesa me fondet e Shoqërive dhe Ndërmarrjeve Shtetërore “, pika 5, pika 27 dhe 37 nenet 1 dhe 2, VKM numër 179, datë 26.02.2020, “Për rregullat, kushtet dhe procedurat e privatizimit të banesave që kanë qënë subject i Ligjit 7652, datë 23.12.1992, “Për Privatizimin e Banesave Shtetërore”, si dhe në Dekretin e Presidentit nr. 1440 datë 04.04.1996 “ Për trajtimin e banesave shtetërore të paprivatizuara neni 1 dhe neni 2 , si edhe neni 192 i Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë paragrafi II , regjistrimi i Pasurive të Paluajtshme të bëhet në bazë të një akti public , të një vendimi gjykate apo të një organi tjetër shtetëror kompetent , si edhe në raste të tjera të parashikuara në ligj , si edhe neni 193/b i Kodit Civil, i propozojmë Keshillit të Bashkisë Divjakë, me datë 27.08 2025:

- 1- Të miratojë përfundimin e procedurës së privatizimit të banesave të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në Agjencine Shtetërore te Kadastres, Drejtoria Vendore Lushnje, për lidhjen e kontratave para noterit për qytetarët që kanë aplikuar sipas listes :
- 2- Për zbatimin e këtij Projekt – Vendimi, ngarkohet Sektori Juridik dhe i Prokurimeve Publike, të ndjekë të gjithë procedurën administrative dhe ligjore.

Konceptoi:

Andi Bullari

KRYETARI

JOSIF GORREA





**Lista e familjarëve , që kanë aplikuar për përfundimin e procedurës së privatizimit të banesave të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në Agjencine Shtetërore te Kadastres, Drejtoria Vendore Lushnje, për lidhjen e kontratave para Noterit.**

- **Ali Ymer Kolonjari**, lindur në Qerret, Elbasan, banues në Shënepremte, me adresë Shënepremte, rruga Arif Murrizi, ndërtesa numër 4, hyrja 1, Apartamenti 2, ka aplikuar dhe ka paraqitur dokumentacionin përkatës për apartamentin e ndodhur në Pallatin numër 2 Sulzotaj, Shk --, Kati i I, e perbere nga 1 dhome dhe 1 kuzhine, me aneks ne fshatin Shënepremte, Zona Kadastrale 3341, i gjithë dokumentacionin ndodhet në dosjen e privatizimit.
- **Aishe Nazif Kolonjari**, lindur në Dorez, Librazhd, banues në Shënepremte, me adresë Shënepremte, rruga Arif Murrizi, ndërtesa numër 6, hyrja 1, Apartamenti 5, ka aplikuar dhe ka paraqitur dokumentacionin përkatës për apartamentin e ndodhur në Pallatin numër 1 Sulzotaj, Shk I, Kati i II, e perbere nga 1 dhome dhe 1 kuzhine, pa aneks ne fshatin Shënepremte, Zona Kadastrale 3341, i gjithë dokumentacionin ndodhet në dosjen e privatizimit.
- **Zarif Mehmet Hamzaj**, lindur në Qerret i Vjetër Lushnje, banues ne Grabjan, me adresë Grabjan, ndertesha numer 64, hyrja 4, Apartamenti 8, Grabjan , ka aplikuar dhe ka paraqitur dokumentacionin përkatës për apartamentin e ndodhur në Pallatin numër 28 Grabjan, Shk II, Kati i III, e perbere nga 1 dhome dhe 1 kuzhine, pa aneks ne fshatin Grabjan , Zona Kadastrale 1827, i gjithë dokumentacionin ndodhet në dosjen e privatizimit.
- **Kadri Xhemal Shuka**, lindur në Broshtan, Gramsh dhe banues ne Grabjan, me adresë Grabjan, ndertesha numer 131, hyrja 0, Apartamenti 0, Grabjan , ka aplikuar dhe ka paraqitur dokumentacionin përkatës për apartamentin e ndodhur në Pallatin numër 34 Grabjan, Shk --, Kati i II, e perbere nga 1 dhome dhe 1 kuzhine, pa aneks ne fshatin Grabjan , Zona Kadastrale 1827, i gjithë dokumentacionin ndodhet në dosjen e privatizimit.

**Konceptoi:  
Andi Bullari**

**KRYETARI  
JOSIF GORREA**

